



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 664 Akti

Nr. 695 Vendimi
Tiranë, më 6.9.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Suela Zhegu	Relatore
Roland Ilia	Anëtar

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Steven Kessler (*online*), në datën 4.9.2023, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Rifat Kojku**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;

Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji relatoren e çështjes, shqyrtoi dhe analizoi dokumentacionin dhe çështjen në tërësi, bazuar në vlerësimin tërësor të procedurave sipas pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Rifat Kojku, gjatë periudhës së rivlerësimit ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës, si dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në datën 15.12.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, zhvilloi procedurat e shpërndarjes së çështjeve me short, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Rifat Kojku, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Roland Ilia dhe Suela Zhegu. Relatore e çështjes me short u zgjodh komisionerja Suela Zhegu.
3. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin e datës 15.1.2021 vendosi fillimin e hetimit administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Genta Tafa (Bungo). Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
4. Në datën 20.1.2021, subjekti i rivlerësimit u njoftua nëpërmjet postës elektronike mbi fillimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, si dhe përbërjen e trupit gjykues, për të cilën deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me asnjë nga anëtarët e tij.
5. Në datën 30.6.2023, subjekti i rivlerësimit, z. Rifat Kojku, njoftoi Komisionin lidhur me një kërkesë të paraqitur pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë mbi deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës për dalje në pension. Kjo kërkesë është protokolluar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë me nr. ** prot., datë 26.6.2023.
6. Komisioni është njohur me vendimin¹ e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me nr. ***, datë 10.7.2023 “Për mbarimin e statusit të magjistratit”, për prokurorin Rifat Kojku në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Sipas këtij vendimi, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në pikën 1 të nenit 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 64, pika 1, shkronja “a”, nenin 65 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 189, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur: “1. Deklarimin e mbarimit të statusit të z. Rifat Kojku, aktualisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. 2. Mbarimi i statusit të magjistratit për z. Rifat Kojku u jep efektet nga data 31.7.2023. 3. Të njoftohet për këtë vendim z. Rifat Kojku, Prokuroria e Përgjithshme dhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit. 5. U shpall në Tiranë, sot, në datën 10.7.2023”.

Ky vendim i është përcjellë subjektit të rivlerësimit dhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 12.7.2023, të KLP-së.

7. Komisioni, përmes postës elektronike me *email*-in datë 19.7.2023, i ka kërkuar subjektit të deklarojë se për çfarë arsye Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vendosur mbarimin e statusit të magjistratit, si dhe të depozitohë kopje të akteve të paraqitura pranë KLP-së.

7.1 Subjekti ka depozituar² kopje të kërkesës drejtuar KLP-së, si dhe relacionin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës në lidhje me mbarimin e statusit të magjistratit, ku rezulton se kërkesa e prokurorit Rifat Kojku është mbështetur në nenet 31 dhe 92 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në faktin se në datën 13.2.2023 subjekti i rivlerësimit ka mbushur moshën 65 vjeç. Në këto kushte, mbështetur në nenet 64 dhe 65 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për shkak edhe të gjendjes jo të mirë shëndetësore, subjekti ka kërkuar të dalë në pension pleqërie.

8. Për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtës së subjektit për t’u dëgjuar, Komisioni, në mbështetje të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, njoftoi z. Rifat Kojku në datën 1.9.2023 mbi të drejtën që gëzon për t’u dëgjuar në seancën dëgjimore, të cilit iu kërkuar të deklarojë nëse ka ushtruar të drejtën e ankimimit ndaj vendimit nr. ***, datë 10.7.2023, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
9. Subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike me *email*-in e datës 4.9.2023, ka informuar Komisionin se nuk ka ushtruar ankim në gjykatë ndaj vendimit mbi mbarimin e statusit të magjistratit me nr. ***, datë 10.7.2023, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe të mos marrë pjesë në seancë dëgjimore, për arsye shëndetësore.

II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

10. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
11. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, konstaton se:
- a) Z. Rifat Kojku ka qenë me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, duke iu nënshtruar kështu procesit të rivlerësimit *ex officio*.
- b) Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me vendimin nr. ***, datë 10.7.2023, ka vendosur deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. Rifat Kojku, me efekt nga data 31.7.2023.
- c) Z. Rifat Kojku nuk ka paraqitur ankim ndaj vendimit nr. ***, datë 10.7.2023, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me të cilin është miratuar kërkesa për mbarimin e statusit të magjistratit.
12. Në pikën 1 të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016 përcaktohen rastet e mbarimit të statusit të magjistratit kur magjistrati: (a) jep dorëheqjen; (b) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit; (c) mbush moshën e pensionit të pleqërisë, sipas parashikimit të këtij ligji; (ç) shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji; (d) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.

² Dërguar nga subjekti me *email*-in datë 22.7.2023.

13. Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit, z. Rifat Kojku, ka kërkuar deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit, duke zgjedhur të dalë në pension pleqërie, kohë kur mbarimi i statusit për shkak të moshës deklarohet nga KLP-ja.
14. Vullneti i subjektit për të ndërprerë marrëdhëniet e tij të punës është shprehur në kërkesën e tij datë 21.6.2023 drejtuar KLP-së, ku shprehet se kjo zgjedhje nga ana e tij bëhet jo vetëm për shkak të plotësimit të kushteve për përfitim pensioni, por edhe për shkak se gjendja e tij shëndetësore përgjatë vitit 2023 ka ardhur në rënie (shkak i cili më herët ka sjellë si pasojë edhe paraqitjen e heqjes dorë prej tij nga pozicioni si drejtues). Bërja prezent e këtij fakti para Komisionit dhe formalizimi me paraqitjen e kërkesës drejtuar KLP-së çmohen nga trupi gjykues si ndërprerje për shkak të vullnetit të subjektit për të lënë detyrën përpara kohe, duke e konsideruar si dorëheqje të tij.
15. Për sa më sipër, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit me veprime konkrete ka hequr dorë nga ushtrimi i detyrës së prokurorit, ndërkohë që ende nuk ka mbushur moshën 67 vjeç, të përcaktuar nga ligji nr. 96/2016 dhe mund të vazhdonte të ushtronte ende detyrën dhe të gëzonte statusin e magjistratit edhe për 2 vite të tjera, trupi gjykues konkludon se kur subjekti i rivlerësimit me vullnetin e tij ka lënë detyrën që ushtronte përkundrejt mundësisë ligjore për të vazhduar ushtrimin e funksionit, kjo situatë faktike kualifikohet sipas parashikimeve të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, dorëheqje nga detyra.
16. Mbarimi i statusit të magjistratit, parashikuar nga shkronja “a” e pikës 1 të nenit 64 dhe nenit 65 të ligjit nr. 96/2016, nuk lidhet vetëm me ndalimin e ushtrimit efektivisht të detyrës në kuptim të ligjit nr. 96/2016, por në të njëjtën kohë dhe në mënyrë të pashmangshme edhe me procesin e rivlerësimit në zbatim të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, duke sjellë për pasojë edhe humbjen e statusit si subjekt rivlerësimi *ex officio* dhe ndërprerjen e procesit të rivlerësimit.
17. Dispozitat kushtetuese dhe ligjore, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, si dhe jurisprudenca e Kolegjit³ në lidhje me procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, parashikojnë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes, duke zbatuar në këtë rast nenin G të Aneksit të Kushtetutës, që parashikon ndalimin e subjektit të rivlerësimit për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i KLGJ-së ose i KLP-së, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
18. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk pengohet nga e drejta e tij për të aplikuar dhe përfituar pension pleqërie me mbushjen e moshës 65 vjeç, në bazë të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, siç edhe faktikisht ka ndodhur, por në kuadër të parashikimeve të ligjit nr. 96/2016, prej të cilit subjekti i rivlerësimit ka gëzuar statusin e magjistratit dhe përfitimet e tjera që rrjedhin prej tij, subjekti ka fituar edhe të drejtën për të qëndruar në detyrë deri në mbushjen e moshës 67-vjeçare dhe detyrimin për t’iu nënshtruar edhe procesit të rivlerësimit.
19. Shprehja e vullnetit të subjektit të rivlerësimit për të mos vijuar ushtrimin e detyrës së prokurorit deri në moshën 67 vjeç konsiderohet dorëheqje nga detyra e prokurorit/statusi i magjistratit, në kuptim të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, që sjell si pasojë ndërprerjen

³ Vendim nr. 9 (JR), datë 23. 3.2021, i Kolegjit.

e procesit të rivlerësimit dhe zbatimin e ndalimit të parashikuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës.

20. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në nenet 64 dhe 65 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Rifat Kojku.
2. Ndalimin e emërimit të z. Rifat Kojku si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 6.9.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta TAFA (BUNGO)

Kryesuese

Suela ZHEGU

Relatore

Roland ILIA

Anëtar

Sekretare gjyqësore

Etmonda Hoxha